



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

ANGLISHTE PËR QËLLIME PROFESIONALE (Biznes)

.Ngarkesa: 6 kredite, 40 seminare, 20 leksione

Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti I, Sem II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Programi i studimit profesional dyvjeçar në “Komunikim shumëgjuhësh në institucione dhe ndërmarrje”

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-se (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Të pajisen studentët me njohuri dhe kompetenca gjuhësore të avancuara për përdorim profesional në kontekste institucionale dhe administrative. Të zhvillohet aftësia për të përdorur gjuhën angleze në mënyrë të saktë, të qartë dhe të përshtatshme në komunikime formale dhe ndërkulturore. Të aftësohen studentët për të komunikuar në mënyrë efektive në mjedise ndërkombëtare pune, duke respektuar etikën dhe normat e komunikimit profesional. Të nxitët përdorimi i strategjive të të nxënimit aktiv dhe autonom përmes simulimeve dhe situatave autentike të komunikimit administrativ.

Objektiva specifike lëndore :

1. Të zhvillohen aftësitë për analizimin dhe prodhimin e teksteve të ndryshme profesionale si shkresa, email-e, raporte, CV dhe letra motivimi.
2. Të përvetësohet terminologjia e specializuar dhe strukturat gjuhësore që përdoren në fushat e administratës, institucioneve dhe ndërmarrjeve.
3. Të aftësohen studentët për të përdorur gjuhën angleze në mënyrë të përshtatur sipas regjistrit dhe stilit që kërkon konteksti profesional.
4. Të zhvillohet aftësia për të marrë pjesë në mënyrë aktive në takime, prezantime, diskutime dhe negociata profesionale.

Rezultate të pritshme të të nxënimit:

1. Hartojë dhe analizojë dokumente profesionale në anglisht (email-e, memo, raporte, CV, letra motivimi etj.).
2. Përdorë gjuhën angleze në mënyrë të sigurt, të saktë dhe të përshtatshme në komunikimin formal verbal dhe joverbal.
3. Përshtasë stilin dhe regjistrin gjuhësor në varësi të audiencës, institucionit dhe qëllimit të komunikimit.
4. Marrë pjesë në mënyrë efektive në takime, prezantime dhe diskutime profesionale në gjuhën angleze.